



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, i thirrur nga kryetari i Dhomës, u mbledh në datë **17 gusht 2026**, ora **11:00**, me pjesëmarrjen e: znj. **Najada Beqaraj** (kryetare), z. **Fabio Isufaj** (anëtar), z. **Resul Alushani**, (anëtar) z. **Elvin Hoxha** (anëtar), z. **Bislim Sinaj** (anëtar), z. **Admir Beqiri** (anëtar) në prezencë të drejtuesit të mbledhjes z. **Tedi Malaveci**, dhe sekretarit të Përgjithshëm, znj. **Jonida Ujkashi**.

Bazuar në pikat e rendit të ditës Këshilli Drejtues, diskutoi, analizoi dhe shqyrtoi lidhur me to. Për pikën e tretë të rendit të ditës dhe diskutime dhe propozime jashtë tij,

VENDOSI:

1. Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të DHKPGJP-së për kryerjen e procesit të zgjedhjes së organeve drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë për mandatin 2026-2030.
2. Mbledhja Asamblesë së Përgjithshme sipas pikës 1 të këtij vendimi të zhvillohet në datë **24.9.2026**.
3. T'i kërkojë kryetarit të Dhomës të respektojë këtë vendim të Këshillit Drejtues në zbatim të Statutit të Dhomës, "*Rregullores së mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë*" dhe kompetencave të Këshillit Drejtues të parashikuara në nenin 34 të ligjit nr. 26/2019 "*Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat*".
4. Ngarkohet Kryetari i Dhomës dhe sekretari i Përgjithshëm të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Dhomës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES

Znj. Najada BEQARAJ

Z. Fabio ISUFAJ

Z. Bislim SINAJ

Z. Resul ALUSHANI

Z. Elvin HOXHA

Z. Admir BEQIRI